



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:271760

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06229156

Pml.nr.581/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit M. G., për shkak të veprave penale: vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1, nënpar.1.1 të kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe keqpërdorimi i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Fushë Kosovë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.40/2024 të datës 13.02.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.796/2024 të datës 15.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25 shtator 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit M. G. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Fushë - Departamenti i Përgjithshëm Kosovë P.nr.40/2024 të datës 13.02.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.796/2024 të datës 15.07.2024.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Fushë Kosovë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.40/2024 e datës 13.02.2024, të dënuarin M. G. e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale: vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së dhe keqpërdorimi i besimit nga neni 330 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim unik burgimi kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 €, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 06.12.2023 e tutje. I dënuarit është obliguar në pagesën e shumës prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, dhe shumën prej 20 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse palët e dëmtuara për realizimin e kërkesave pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Me të njëjtin aktgjykim i dënuari Bekim Krasniqi është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.1, nënpar.1.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 06.12.2023 e tutje.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.796/2024 e datës 15.07.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve M. G. dhe B. K., kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, avokati Edolind Bytyqi nga F. K., për shkak të shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen të e kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.342/2024 e datës

20.09.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale pasi që me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë vlerësuar fare rrethanat lehtësuese, por vetëm përmenden në mënyrë deklarative dhe atë bashkëpunimin e të dënuarit në fazën e hetimeve, pranimin e fajësisë që nga seanca fillestare, si dhe ndihma e tij në gjetjen dhe kthimin e sendeve të vjedhura dhe dorëzimin vullnetar të tij. Pretendohet se shkalla e bashkëpunimit do të duhej të ishte përcaktuesi kryesor për llojin dhe lartësinë e dënimit.

Në vijim të kërkesës pretendohet për shkelje të ligjit penal pasi që konsiderohet se nuk është marrë për bazë pranimi i fajësisë, sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, dhe fakti se sendet e vjedhura janë kthyer të dëmtuarve dhe të cilët kanë hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike. Për më tepër, theksohet fakti se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë marrë për bazë gjendja personale dhe familjare e të dënuarit, mirëpo është theksuar si rrethanë rënduese e kaluara e tij se më parë ka qenë i dënuar edhe pse vepra penale në fjalë ishte kryer gjatë kohës sa i dënuari ishte i mitur.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimi i kundërshtuar kundër të cilit është parashtruar kërkesa, nuk përmban shkelje për të cilat pretendohet.

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit fillimisht duhet theksuar faktin se i dënuari në shqyrtimin fillestar kishte bërë pranimin e fajësisë dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara, pranimi i fajësisë është aprovuar. Është e

rëndësishme të potencohet fakti se nga shkresat e lëndës, përkatësisht procesverbali i shqyrtimit fillestar të datës 09.02.2024, del se i dënuari në mënyrë vullnetare ka bërë pranimin e fajësisë në prezencë të mbrojtësit të tij dhe i cili pranim është konstatuar se ishte në harmoni të plotë me dispozitën e nenit 242 par.1 të KPPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vlerësuar pretendimet e theksuara përkitazi me shkeljen e ligjit penal, përkatësisht se ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim i ashpër dhe me këtë rast është bërë shkelja e ligjit penal, vlerësoj se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal nga ana e gjykatës së shkallës së parë, meqë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPP-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkualuar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkualuar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Përtej kësaj, gjykata e shkallës së parë në faqen e katërt të aktgjykimit të saj ka dhënë arsyetim të hollësishëm për të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe mbi këtë bazë ka bërë shqiptimin e dënimit dhe me këtë rast del se si rrethanë rënduese janë çmuar fakti se i njëjti edhe më parë kishte kryer vepra penale të kësaj natyre duke listuar edhe aktgjykimet e mëparshme, andaj, nga kjo del se arsyetimin e dhënë nga gjykata e shkallës së parë në tërësi e aprovon edhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.581/2024, më 25 shtator 2024

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala